



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 320/7 prot.

Datë 12/03/2024

V E N D I M
Nr. 276/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12/03/2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK në procedurën e prokurimit “*Proçedurë e Hapur e thjeshtuar – Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm fitues për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)*” me Nr. REF-91668-12-19-2023, me objekt: *loti 1: “Blerje materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja te Spitalit Rajonal Vlore”* me fond limit 17,754,400 Lekë, pa TVSH ose 173,129.2 (*Njeqind e shtedhjete e tre mije e njeqind e njezete e nente pike dy*) EURO pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 19.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

Ankimues: Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Montal” SHPK, me NIPT: J62009007F & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK me NIPT: J61827062E dhe adresë: *DERVISH HIMA-3KULLAT K.3 AP9/2, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Vlorë
Adresa: Lagja “Partizani”, Vlorë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin*

e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesa është sjellë dy herë me anë të postës elektronike dhe në rrugë shkresore, ndaj edhe ankimet e tyre do të bashkohen në një dosje dhe do të gjykohen në një vendim të etëm.

I.3. Operatori ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.12.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar – Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm fitues për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)” me Nr. REF-91668-12-19-2023, me objekt: loti 1: “Blerje materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja te Spitalit Rajonal Vlore” me fond limit 17,754,400 Lekë, pa TVSH ose 173,129.2 (Njeqind e shtedhjete e tre mije e njeqind e njezete e nente pike dy)

EURO pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 19.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

II.2. Më datë 19.01.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Në datën 25.01.2024 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Aquarius Medical” shpk 00 leke kualifikuar
2. BOE “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK 17.587.000 leke kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet se më datën 01.02.2024 autoriteti kontraktor publikuar njoftimin e anulimit, për procedurën e mësipërme të prokurimit, me argument se nuk është paraqitur ansnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë.

II.5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK skualifikohet në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

“BOE Montal shpk dhe Biometric Albania ,shpk kane paraqitur ne sistemin elektronik certifikatat Iso, certifikatate konformiteti CE, si dhe autorizim prodhuesi ne gjuhe te huaj(anglisht dhe italisht) dhe jo ne Gjuhen shqipe,pervec dokumentave te kompanise prodhuese “STORZ” qe jane te perkthyer dhe te noterizuara me nr rep 199/200 dt 13.01.2024.Mbeshtetur ne ligjin e prokurimit publik Neni 74’’ dokumentat e tenderit’’ pika 1 citoheT ’’Autoriteti ose enti kontraktor, ne hartimin e dokumentave te tenderit,perdor dokumenta standarte,sipas percaktimit ne rregullat e prokurimit publik dhe i ve ne dispozicion falas ne rruge elektronike.Ne dokumentat standarte te kesaj procedure dhe pikerisht ne formularin e kriterëve te perzgjedhjes si dhe ne kriteret e vecanta te kualifikimit pikat 4,5,6,eshte cilesuar qe dokumentat duhen te jene te perkthyer ne Gjuhen Shqipe dhe te noterizuara.’’

II.6. Në datën 09.02.2024, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK ka paraqitur ankesë, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes në procedurën e prokurimit të sipërcituar si dhe revokimin e anulimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 320/2 prot, datë 12.02.2024.

II.8. Në datën 12.02.2024, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK ka paraqitur po të njëjtën ankesë në rrugë shkresore protokolluar me tonën me nr. 327.

II.9. Me shkresën nr. 759 prot, datë 16.02.2024 me objekt: “*Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”loti1 me REF-91668-12-19-2023*”, protokolluar me tonën me nr. 320/3 prot datë 19.02.2024 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mos pranojë ankesën.

II.10. Me shkresën nr. 320/4 prot., datë 06.03.2024 me objekt “*Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur dhe për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi i është drejtuar bashkimit të operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK me njoftimin për seancë dëgjimore me datë 08.03.2024, ora 10:00, në ambientet e KPP.

II.11. Në datën 08.03.2024, ora 10:00 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik u zhvillua seanca dëgjimore në prani të përfaqësuesit të operatorit ekonomik “*MONTAL*” SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij si dhe anulimit të procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 20.12.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar – Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm fitues për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)” me Nr. REF-91668-12-19-2023, me objekt: loti 1: “Blerje materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja te Spitalit Rajonal Vlore” me fond limit 17,754,400 Lekë, pa TVSH ose 173,129.2 (Njeqind e shtedhjete e tre mije e njeqind e njezete e nente pike dy) EURO pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 19.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

III.1.2. Më datë 19.01.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.3. Në datën 25.01.2024 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Aquarius Medical” shpk 00 leke kualifikuar
2. BOE “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK 17.587.000 leke kualifikuar

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet se më datën 01.02.2024 autoriteti kontraktor publikuar njoftimin e anulimit, për procedurën e mësipërme të prokurimit, me argument se nuk është paraqitur ansnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë.

III.1.5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK skualifikohet në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

“BOE Montal shpk dhe Biometric Albania ,shpk kane paraqitur ne sistemin elektronik certifikatat Iso, certifikatate konformiteti CE, si dhe autorizim prodhuesi ne gjuhe te huaj(anglisht dhe italisht) dhe jo ne Gjuhen shqipe,pervec dokumentave te kompanise prodhuese “STORZ” qe jane te perkthyer dhe te noterizuara me nr rep 199/200 dt 13.01.2024.Mbeshtetur ne ligjin e prokurimit publik Neni 74” dokumentat e tenderit” pika 1 citoheT ”Autoriteti ose enti kontraktor, ne hartimin e dokumentave te tenderit,perdor dokumenta standarte,sipas percaktimit ne rregullat e prokurimit publik dhe i ve ne dispozicion falas ne rruge elektronike.Ne dokumentat standarte te kesaj procedure dhe pikerisht ne formularin e kriterëve te perzgjedhjes si dhe ne kriteret e vecanta te kualifikimit pikat 4,5,6,eshte cilesuar qe dokumentat duhen te jene te perkthyer ne Gjuhen Shqipe dhe te noterizuara.”

III.1.6. Në datën 09.02.2024, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK ka paraqitur ankesë, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit të sipërcituar si dhe revokimin e anulimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 320/2 prot, datë 12.02.2024.

III.1.8. Në datën 12.02.2024, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK ka paraqitur po të njëjtën ankesë në rrugë shkresore protokolluar me tonën me nr. 327.

III.1.9. Me shkresën nr. 759 prot, datë 16.02.2024 me objekt: “Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja të Spitalit

Rajonal Vlorë”loti 1 me REF-91668-12-19-2023”, protokolluar me tonën me nr. 320/3 prot datë 19.02.2024 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mos pranojë ankesën.

III.1.10. Me shkresën nr. 320/4 prot., datë 06.03.2024 me objekt “Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur dhe për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi i është drejtuar bashkimit të operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK me njoftimin për seancë dëgjimore me datë 08.03.2024, ora 10:00, në ambientet e KPP.

III.1.11. Në datën 08.03.2024, ora 10:00 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik u zhvillua seanca dëgjimore në prani të përfaqësuesit të operatorit ekonomik “MONTAL” SHPK.

III.1.12. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.13. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si

dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.1.14. Në interpretim të sa më sipër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka detyrimin t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Në rastin konkret KPP vëren, se momenti procedural i kërimit të dokumenteve origjinale dhe verifikimi i tyre nga ana e autoritetit kontraktor për bashkimin e operatorëve ekonomikë "Montal" SHPK & "BIOMETRIC ALBANIA" SHPK, ka qenë minimumi data **25.01.2024**, datë në të cilën ankimesi është kualifikuar në sistemin e prokurimeve elektronike dhe maksimumi 5 ditë pas kualifikimit në sistem dhe përpara njoftimit të fituesit ose anulimit, duhej që ti kërkonte paraqitjen e dokumentacionit fizik për plotësimin e kriterëve kualifikuesë në përputhje me nenin 26 pika 6 të vkm dhe më pas duhet të vijonte me hapat e mëtejshëm. Sikundër rezultojnë në faktet e parashtruara më sipër, autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar përgjatë kësaj periudhe nga ana e ofertuesit të kualifikuar dorëzimin e dokumentacionit origjinal dhe verifikimin e kapaciteteve të cilat ishin përmbushur deri në atë moment me anë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ndërkohë, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka kryer disa ditë më vonë, në datë 01.02.2024 skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë "Montal" SHPK & "BIOMETRIC ALBANIA" SHPK dhe anulimin e procedurës së prokurimit. Pra, veprimet e mësipërme të autoritetit kontraktor janë kryer, në kundërshtim me nenin 26 pika 6 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik rithekson edhe njëherë faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, apo akoma më tej dhe afatet për verifikim të parashikuara shprehimisht në ligj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu, KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka gabuar në zbatimin dhe interpretimin e ligjit në rastin konkret, pasi nuk ka marrë parasysh ndryshimet ligjore në lidhje me nenin 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, ku parashikohet shprehimisht se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si**

dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.1.15. Sa më sipër, KPP gjykon, se skualifikimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues është kryer në shkelje të parashikimeve ligjore aktualisht në fuqi. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të kishte verifikuar dokumentacionin origjinal të ankimuesit përpara veprimit procedural të publikimit të njoftim-fituesit ose të anulimit në sistemin e prokurimeve elektronike. KPP e gjen veprimin e autoritetit kontraktor, jo në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Akoma më tej, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka kryer veprime jo në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, pasi sikundër pasqyruam më sipër, ka kryer procesin e vlerësimit duke e kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK dhe më pas ka vendosur skualifikimin e tij dhe më pas anulimin e procedurës pa asnjë mbështetje ligjore. KPP i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me momentin procedural të verifikimit të dokumentacionit origjinal dhe akoma më tej lidhur me anulimin e procedurës. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efijencës parashikuar në nenin 2 të LPP-së. Në këtë kuptim, KPP e gjen skualifikimin e ankimuesit dhe anulimin e procedurës të pabazuar në ligj dhe në kapërcim të afateve ligjore në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën me nr. ankimi elektronik A/2024/3795 dhe me nr. 320 protokollin datë 09.02.2024, si dhe ankesën me nr. 320 prot., datë 12.02.2024 të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-19625-02-14-2022, me objekt “Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 137.991.275 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 17.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator.

3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin mbi anulimin e procedurës.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Montal” SHPK & “BIOMETRIC ALBANIA” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

